



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut

Lloji i punës: Raport pune

“RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2015”

Junik, mars 2016

Kuvendi i Komunës së Junikut në përputhje me obligimet që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Junikut, Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe ligjet e tjera në Republikën e Kosovës, për vitin 2015 harton këtë:

RAPORT P U N E

Kuvendi i Komunës së Junikut është organi më i lartë në Komunën e Junikut i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin Mbi Zgjedhjet Lokale (neni 35 paragrafi 1. i LVL).

Kjo është legjislatura e katërt e këtij organi e dalë nga zgjedhjet lokale 2013.

Kuvendi i Komunës së Junikut numëron gjithsejtë 15 anëtarë prej të cilëve 9 janë meshkuj dhe 6 femra. Në kuvend janë të përfaqësuara katër subjekte politike: AAK me 6 këshilltarë; LDK me 5 këshilltarë; LVV me 2 këshilltarë dhe PDK me 2 këshilltarë.

Përveç Kuvendit si organ në kuadër të tij janë të themeluara edhe trupa ndihmës siç janë komitetet dhe komisionet. Deri më tash janë të themeluara 3 komitete (dy të përhershme Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete) dhe (një komitet tjetër – Komiteti për Shërbime Publike), Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, 2 komisione (Komisioni për Emërtimin e Zonave të Qarkullimit Publik dhe Komisioni për Përzgjedhjen e Stëmës së Komunës së Junikut) si dhe Grupi i Femrave të Komunës së Junikut.

Mirëpo për të gjitha çështjet tjera siç janë dërgimi i materialit, arkivimi si dhe evidentimi protokollar i të gjithë materialit të kuvendit është punuar në përputhje me ligjet si dhe Rregulloren e punës së kuvendit duke respektuar atë sa ka qenë e mundur Planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2015.

Në emër të Grupit të Femrave të Regionit të Dukagjinit (Peja, Juniku, Gjakova dhe Rahoveci) dhe mbështetur nga Qeveria Zvicerane, përmes Organizatës HELVETAS Swiss Intercooperation në kuadër të projektit DEMOS (decentralizimi dhe përkrahja komunave), është mbajtur konferencën regjionale me temën: **"Gruaja dhe vendimmarrja në komunë"**

Qëllimi i konferencës ishte shkëmbimi i përvojave të mira nëpër komuna të ndryshme, identifikimi i sfidave dhe pengesave në procesin e integritetit të gruas në proceset vendimmarrëse dhe ato politike si dhe rekomandimet për integritetin dhe përmirësimin e nivelit të përfaqësimit të gruas në nivelin komunal, pjesa ekzekutive, kuvend/legjislative dhe në nivel të fshatit.

Në kuadër të projektit DEMOS partnere e të cilit është edhe Komuna e Junikut është organizuar vizita studimore në Republikën e Sllovenisë e cila u mundësua nga organizata HELVETAS Swiss Intercooperation e cila financohet nga Qeveria e Zvicrës. Vizita ka qenë 3 ditore dhe pjesëmarrës në këtë vizitë ishin 7 komuna partnere të projektit DEMOS: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Rahovec, Junik, Shtime dhe Lipjan. Secila nga këto komuna ka qenë e përfaqësuar nga 2 përfaqësues, kryesuesi i kuvendit nga këto komuna si dhe udhëheqësja e grupit të grave asambleiste. Vlen të theksohet se organizimi i vizitës është ndihmuar nga Asociacioni i Komunave dhe Qyteteve të Sllovenisë.

Në këtë vizitë studimore janë prezantuar dhe trajtuar shumë tema si: sistemi Slloven i vet-qeverisjes lokale – korniza institucionale; financimi i komunave; ndarja e kompetencave midis qeverisë qendrore dhe lokale; roli dhe kompetencat e këshillave komunale; komiteti monitorues dhe komitetet tjera komunale; zhvillimi i vetëqeverisjes lokale në sytë e qeverisë qendrore; roli i asociacionit në procesin e përmirësimit të vetëqeverisjes lokale në Slloveni në ngritjen e kapaciteteve të këshilltarëve komunal si dhe realizimin e auditimit të brendshëm si shërbim të asociacionit; mënyra se si raporton ekzekutivi në legjislativ dhe roli dhe komunikimi me këshillin e fshatit; të drejtat dhe detyrat e anëtarit të këshillit komunal; raporti i këshillit komunal me organet e tjera komunale; marrëdhëniet midis këshillit komunal dhe kryetarit të komunës; këshilli komunal dhe komisioni monitorues dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrje; marrëdhëniet e nivelit lokal me nivelin qendror; statutin e komunave dhe për rregulloren e punës së këshillit komunal; për rolin e këshillit komunal në procesin e hartimit të politikave lokale; ndikimin e këshillit komunal në zhvillimin ekonomik të komunës; rolin e këshillit komunal në lidhje me shërbimet publike; çështjet gjinore të adresuara në nivel komunal si dhe komunikimi i këshilltarëve me qytetarët; përgatitja dhe zbatimi i buxhetit komunal; ndërveprimi ndërmjet kryetarit, stafit komunal, komisionit për financa dhe zhvillim ekonomik si dhe kompetencat në krijimin e politikave të taksave komunale; etj. .

Po ashtu në gjysmën e vitit 2015 është mbajtur edhe një trajnim dy ditor për anëtarët e Kuvendeve Komunale të regjionit i mbajtur në Gjakovë dhe i organizuar nga ana e DEMOS-it. Edhe në këtë trajnim interesimi dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut ka qenë relativisht i mirë. Edhe nga ky trajnim mendoj që anëtarët që kanë marrë pjesë, kanë përfituar përvoja të reja se si mund të kontribuojnë më shumë gjatë mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Në muajin nëntor respektivisht me datat 26 dhe 27 nëntor në Prevallë është mbajtur “Punëtoria mbi taksat, tarifat dhe gjobat komunale” në kuadër të projektit DEMOS (decentralizimi dhe përkrahja e komunave) dhe e organizuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation. Në këtë punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe drejtorët e drejtorive: për administratë; shërbime publike; urbanizëm; zhvillim ekonomik etj. .

Në këtë punëtori janë trajtuar tema si: korniza ligjore për taksat, tarifat dhe gjobat komunale; kategoritë dhe llojet e taksave, tarifave dhe gjobave komunale; rregullorja për taksat, tarifa dhe gjobat komunale; roli i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe mundësitë; mënyra e vjeljes së të hyrave nga shfrytëzimi i pronës komunale; mënyra e vjeljes së të hyrave nga urbanizmi, kadastra dhe gjeodezia; mënyra e vjeljes së të hyrave nga veprimtaritë afariste; mënyra e vjeljes së të hyrave nga shërbimet komunale; mënyra e vjeljes së të hyrave nga lëshimi i dokumenteve zyrtare; performanca e komunës në raport me të hyrat vetanake dhe monitorimi nga Komiteti për Politikë dhe Financa; etj.

Gjatë vitit 2015 Kuvendi i Komunës së Junikut ka mbajtur gjithsejtë 11 mbledhje të rregullta derisa mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka mbajtur asnjë për arsye se për të tilla mbledhje nuk është paraqitur nevoja.

Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për komunën e Junikut.

RREGULLORET:

Kuvendi i Komunës së Junikut për vitin 2015 ka miratuar gjithsejtë 3 rregullore, kurse dy të tjera janë në procedurë.

1. Rregulloret e miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut në vitin 2015 janë:
 - 1.1. Rregullorja për organizimin e transportit rrugor lokal brenda territorit të komunës së Junikut (vendimi i KKJ numër 02/50 i datës 29.05.2015);
 - 1.2. Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016 (vendimi i KKJ numër 02/62 i datës 30.09.2015);
 - 1.3. Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Junikut (vendimi i KKJ numër 02/63 i datës 30.10.2015);

DOKUMENTET STRATEGJIKE:

Kuvendi i Komunës së Junikut për vitin 2015 ka miratuar gjithsejtë 3 dokumente strategjike, kurse dy të tjera janë në procedurë.

Dokumentet strategjike komunale të miratuara në vitin 2015 janë:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2016-2018 (vendimi i KKJ numër 02/56 i datës 26.06.2015);
2. Plani për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe katastrofat tjera në komunën e Junikut (vendimi i KKJ numër 02/58 i datës 26.06.2015);
3. Plani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar (vendimi i KKJ numër 02/68 i datës 30.11.2015).

Në hartim e sipër janë edhe dokumentet në vijim:

1. Plani i veprimit për transparencë në komunën e Junikut (vendimi i KKJ numër 02/69 i datës 30.12.2015), dhe
2. Plani për efikasitet të energjisë 2016-2020 në komunën e Junikut (vendimi i KKJ numër 02/70 i datës 30.12.2015).

BUXHETI:

I. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut për vitin 2015 ka qenë **1.285.347,00 €**, dhe është i shpërndarë në linjat buxhetore si në vijim:

1. Paga dhe mëditje: **965.076,00 €**,
2. Mallra dhe shërbime: **111.298,00 €**,
3. Shpenzime komunale: **30.000,00 €**,
4. Subvencione dhe transferte: **7.000,00 €**,
5. Investime kapitale: **171.973,00 €**.

(vendimi i KKJ numër 02/20 i datës 29.09.2014)

Përveç kësaj gjatë vitit 2015 Kuvendi i Komunës së Junikut ka nxjerrë gjithsejtë 41 akte; 39 vendime; 1 njoftim dhe 1 rekomandim.

Në vijim në mënyrë tabelore po paraqesim aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2015.

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2015

Nr.	Emërtimi	Numri i vendimit	Data e vendimit	Data e miratimit	Vërejtje :
01	Vendimi për formimin e Komisionit për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut	02/31	30.01.2015	30.01.2015	
02	Vendimi për datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të KK Junik për vitin 2015	02/32	30.01.2015	30.01.2015	
03	Vendimi për pagesën e punës së Komisionit për Emërtimin e Zonave të Qarkullimit Publik	02/33	30.01.2015	30.01.2015	
04	Vendim për miratimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2015	02/34	30.01.2015	30.01.2015	
05	Vendim për miratimin e Planit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2015	02/35	06.02.2015	06.02.2015	
06	Vendim për miratimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2015	02/36	06.02.2015	06.02.2015	
07	Vendim për shkarkimin e një anëtari të Komitetit për Komunitete	02/37	06.02.2015	06.02.2015	
08	Vendim për transferimin e mjeteve financiare	02/38	27.02.2015	27.02.2015	
09	Vendim për hapjen e diskutimit publik për projekt Rregulloren për organizimin e transportit rrugor lokal brenda territorit të komunës së Junikut	02/39	27.02.2015	27.02.2015	
10	Vendim për plotësimin e Komitetit për Komunitete me një anëtar	02/40	27.02.2015	27.02.2015	
11	Vendim për zgjedhjen e kryetarit të Komisionit për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut	02/41	17.03.2015	17.03.2015	
12	Vendim për fillimin e hartimit të plotësimit ndryshimeve të	02/42	27.03.2015	27.03.2015	

	Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016				
13	Vendim për fillimin e hartimit të projekt Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Junikut	02/43	27.03.2015	27.03.2015	
14	Vendim për miratimin e Strategjisë së Grupit të Femrave të Komunës së Junikut për vitin 2015	02/44	27.03.2015	27.03.2015	
15	Vendim për miratimin e raportit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2014	02/45	27.03.2015	27.03.2015	
16	Vendim për hapjen e diskutimit publik për projekt Planin për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe katastrofat e tjera në komunën e Junikut	02/46	29.04.2015	29.04.2015	
17	Vendim për fillimin e hartimit të projekt Rregullores për punën e Komitetit për Shërbime Publike	02/47	29.04.2015	29.04.2015	
18	Vendim për miratimin e Planit të punës së Komisionit për Përzgjedhjen e Stëmës së Komunës së Junikut	02/48	29.04.2015	29.04.2015	
19	Vendim për shfuqizimin e pjesshëm të Kuvendit të Komunës së Junikut me numër 01/18	02/49	29.04.2015	29.04.2015	
20	Vendim për dhënien e titullit “QYTETAR NDERI” i Junikut	02/50	29.04.2015	29.04.2015	
21	Vendim për ndërrimin e destinimit të parcelës kadastrale numër 2034	02/51	29.05.2015	29.05.2015	
22	Vendim për miratimin e Rregullores për organizimin e transportit rrugor lokal brenda territorit të komunës së	02/52	29.05.2015	29.05.2015	

	Junikut				
23	Rekomandim pas shqyrtimit të petitionit të qytetarëve të Junikut lidhur me ndërtimin e xhamisë në qendër të Junikut	02/53	29.05.2015	29.05.2015	
24	Vendim për formimin e Grupit të punës për hartimin e projekt Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2016	02/54	29.05.2015	29.05.2015	
25	Vendim për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në këtë vit	02/55	26.06.2015	26.06.2015	
26	Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2016-2018	02/56	26.06.2015	26.06.2015	
27	Vendim për miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e stemës së Komunës së Junikut	02/57	26.06.2015	26.06.2015	
28	Vendim për miratimin e Planit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe katastrofat tjera në komunën e Junikut	02/58	26.06.2015	26.06.2015	
29	Vendim për hapjen e diskutimit publik për plotësim-ndryshimet e Rregullores së tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2016	02/59	31.07.2015	31.07.2015	
30	Njoftim	02/60	21.09.2015	21.09.2015	
31	Vendim për miratimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2016	02/61	30.09.2015	30.09.2015	
32	Vendim për miratimin e plotësim-ndryshimeve të Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016	02/62	30.09.2015	30.09.2015	
33	Vendim për miratimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat,	02/63	30.10.2015	30.10.2015	

	vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Junikut				
34	Vendim për shkarkimin e anëtarëve të Komitetit për Shërbime Publike	02/64	30.10.2015	30.10.2015	
35	Vendim për miratimin e buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2016	02/65	30.10.2015	30.10.2015	
36	Vendim për kundërshtimin e realizimit të projektit për shfrytëzimin e burimit të Erenikut të Vogël nga ana e Komunës së Gjakovës	02/66	30.10.2015	30.10.2015	
37	Vendim për miratimin e Planit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2016	02/67	30.11.2015	30.11.2015	
38	Vendim për miratimin e Planit Lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar	02/68	30.11.2015	30.11.2015	
39	Vendim për fillimin e hartimit të projekt Planit të veprimit për transparencë në Komunën e Junikut	02/69	30.12.2015	30.12.2015	
40	Vendim për fillimin e hartimit të projekt Planit komunal për eficiencë të energjisë në Komunën e Junikut	02/70	30.12.2015	30.12.2015	
41	Vendim për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shërbime Publike	02/71	30.12.2015	30.12.2015	

Përfundim:

Në këtë raport pune janë pasqyruar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, por kurrësi nuk mund ta konsiderojmë si të plotë, pasi që nuk kanë mundur të pasqyrohen edhe aktivitetet e trupave ndihmës të Kuvendit të Komunës së Junikut për shkak të mungesës së raporteve të punës së tyre (përveç raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2015 i cili i është prezantuar kuvendit për shqyrtim dhe miratim mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës së Junikut) për vitin 2015 të cilat pas hartimit duhet t'i prezantohen Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

Përfundimisht Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2015 ka funksionuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke u ballafaquar me probleme si të natyrës teknike (logjistike) ashtu edhe të

natyrës ligjore dhe bashkëpunimit me ekzekutivin sa u përket respektimit të procedurave ligjore lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike komunale.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Junikut, shpresoj që me hartimin e raportit tjetër të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut t'i kemi edhe raportet e punës së trupave ndihmës (komiteteve) në mënyrë që raporti i punës të jetë më gjithëpërfshirës dhe i plotë.

Me këtë rast në emër të Kuvendit të Komunës së Junikut Ju falënderoj të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut për kontributin e dhënë deri më tash.

Pjesë përbërëse e këtij raporti është edhe raporti financiar mbi shpenzimet e Kuvendit të Komunës së Junikut dhe trupave ndihmës (Komiteti për Politikë dhe Financa – KPF; Komiteti për Komunitete – KK; Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB; Komiteti për Shërbime Publike KSHP – KSHP; Grupi i Femrave të Komunës së Junikut – GFKJ; Komisioni për Emërtimin e Zonave të Qarkullimit Publik – KEZQP; dhe Komisioni për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut – KPSKJ) të këtij organi për vitin 2015.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ _____
kryesues